




Programi i Partneritetit Evropian me Komunitat

# Raporti vjetor i EU PROGRES

Korrik 2011 - Qershor 2012



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Sprovodi program



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
  
Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

eu progres

Program evropskog partnerstva sa opštinama

## Rezime

Në fund të vitit të dytë të zbatimit të Partneritetit Evropian me komuna – EU PROGRES, mund të thuhet se programi me të vërtetë është duke lëvizur drejt qëllimit: rritjes së stabilitetit dhe zhvillimit shoqëroro-ekonomik të rajoneve më të varfra në Serbi me potencialin më të madh për shpërthim të konfliktit - Serbi jugore dhe jugperëndimore.

Disa projekte **ekonomike** të mbështetur nga EU PROGRES do të mundësojnë **investime në vlerë prej më shumë se 7.5 milion euro** dhe hapje të rreth 1250 vendeve të punës gjatë tri deri pesë viteve të ardhshme. Zbatimi i projekteve të krijimit të infrastrukturës komunale edhe të mjedisit jetësor duhet të japin rezultate në hapjen e **100 vendeve shtesë të punës**, përdërisa mbështetja e projekteve të vogla në ndërtimin e shoqërisë civile ka hapur 40 vende të punës të përkohshme dhe permanente për gra dhe persona me aftësi të kufizuara.

Puna e EU PROGRES në fushën e barazisë gjinore ka bërë tashmë një **ndryshim të madh pozitiv në shoqëri**. Në jugperëndim dhe në rrethin e Toplicës të gjitha komunat kanë themeluar mekanizmat vendore lidhur me barazinë gjinore (MBGJ) dhe për herë të parë gjashtë komuna kanë ndarë fonde për aktivitete specifike lidhur me barazinë gjinore në shumë totale prej 90.000 euro; pas zgjedhjeve të majit, **numri i grave përfaqësuese në asambljetë lokale, të cilat ishin qëllimi i ndërhyrjes është 29%** - mesatarisht është 11% më i lartë se pas zgjedhjeve të vitit 2008. Asistenca e grupeve të cënueshme ishte shumëdimensionale: në tri komuna përmes Qendrave këshillëdhënëse të qytetarëve është ofruar ndihmë ligjore falas rreth 600 njerëzve; 18 projekte të Fondit për pjesëmarrje të qytetarëve kanë mbështetur punësimin dhe integrimin social të 600 personave. Së fundi, në kuadër të Programit vëmendje e veçantë iu është kushtuar kushteve të vështira të jetesës të popullsisë Rome, dhe është hartuar projekti i cili duhet të siguroj qasje në ujë të pijshëm për 800 familje në vendbanimet e Novi Pazarit, Vranjës dhe Surdulicës.

Prania e një Programi të madh zhvillimor ndërkombëtar që sjell së bashku Bashkimin Evropian, Qeverinë Zvicerane, Qeverinë e Serbisë dhe Kombet e Bashkuara, ka kontribuar fuqishëm në përmirësimin e **stabilitetit** në zonat më të ndjeshme në vend. Programi ka realizuar më shumë se dhjetë ngjarje të profilit të lartë, duke përfshirë vizitat e **katër ambasadorëve**. Të gjitha vizitat janë përdorur për të nxitur reformat sociale si dhe përfshirjen dhe bashkëpunimin e udhëheqësve vendorë.

Megjithatë, bartësi kryesor i **ndryshimeve pozitive në ekonomi**, i cili duhet drejtpërdrejt të përmirësoj konkurrencën e rajonit, paraqet mbështetjen e Programit aktiviteteve të komunës: hartimi i dokumentacionit të planifikimit do të shërbejë si bazë për përgatitjen e dokumenteve teknike që mund të tërheqin një investim shtesë prej 50 milionë; themelimi i shërbimit "gjithçka në një vend" do të shkurtojë ndjeshëm kohën e investitorëve për të filluar projekte; buxhetimi programor, planet e investimeve kapitale dhe dokumentacioni teknik do të lehtësojnë zbatimin e planeve të zhvillimit lokal dhe projekteve të infrastrukturës; përpjekjet për të përmirësuar përgjegjësinë, efikasitetin dhe transparencën në financat komunale janë elemente thelbësore në luftën kundër korrupsionit; mbledhja e subjekteve të biznesit në grupe do të ofrojë mundësi për të sjellë risi, dhe do të përmirësoj proceset biznesore për të fituar tregji (të reja).

Pothuajse çdo studim i **pengesave për investim** tregon se pengesa kryesore për zhvillim më të shpejtë, dhe zbatim më efektiv dhe efikas të projekteve është mungesa e dokumenteve të



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

eu progres

Program evropskog partnerstva sa opštinama

planifikimit dhe dokumentacionit teknik të projekteve. Roli këshillëdhënës dhe mbikëqyrës i EU PROGRES në hartimin e dokumentacionit teknik njihet si vendimtare në nivelin lokal. Përveç 26 milion euro për projekte ndër-komunale, projektet e dokumentacionit teknik për infrastrukturën lokale kanë kapacitet absorbuese prej 14 milionë eurosh, që është gjithsej 40 milionë euro. Për më tepër, kursimet që bëhen pjesërisht për shkak të cilësisë së specifikimit të tenderit - i cili përgatitet me mbështetjen e Programit - vlerësohen në 370 000 euro.

Pritet që **ndikimi i projekteve të infrastrukturës** në jetën e njerëzve të zakonshëm do të jetë i madh: përveç krijimit të vendeve të punës dhe lehtësimit të investimeve të ardhshme, përmes projekteve lokale shoqëro-infrastrukturore 680 fëmijë nga lista e pritjes për kujdesi ditor në çerdhe do të përfitojnë kujdesin, dhe do të përmirësohet efikasiteti i energjisë në shkolla, të cilat përfshijnë 4500 nxënës dhe mësues. Nëpërmjet projekteve të infrastrukturës lokale të komunitetit kushtet sanitare të mjaftueshme do të krijohen për 160 shitës të produkteve bujqësore dhe të qumështit, ndërsa 3500 familje do të kenë uji të pijshëm më kualitativ. Për më tepër, pritet që projektet lokale mjedisore të infrastrukturës të përmirësojnë kushtet sanitare dhe të zvogëlojnë rreziqet shëndetësore për 5000 njerëz që jetojnë pranë lumenjve të parregulluara, dhe se do të krijojnë kurse në faturat e tyre të energjisë deri në 15 për qind.

Cilësi e veçantë e EU PROGRES është, megjithatë, puna në "qeverisjen e mirë si temë transversale." Ky koncept u transferua në situata të jetës, dhe projektet e vogla ndër-komunale dhe infrastrukturale janë të lidhur me qeverisjen e mirë, e që në atë mënyrë të përmirësohet qëndrueshmëria e rezultateve dhe të rritet "pronësia" nga ana e komunave.

Çështja e qëndrueshmërisë së intervencës gjithmonë ka qenë një rëndësi qendrore për përparimin e EU PROGRES. Programi është dizajnuar ashtu që të mbështes ndërtimin e kapaciteteve të të gjithë përdoruesve të drejtpërdrejtë, që ata të mund të marrin përsipër "pronësinë" dhe kështu të fuqizohen për të kryer mandatin e parashikuar në vende të ndryshme në legjislacion / statute, përderisa EU PROGRES duhet të mbajë rolin mbikëqyrës dhe këshillëdhënës. Kjo është e njohur në të gjeturat e vlerësimit të Programit fillestar në mes të kohëzgjatjes së programit, dhe paraqitet si pozitive në raportin e misionit të EU për të monitoruar rezultatet. Përsosmëria në zbatim është njohur edhe brenda UNOPS dhe EU PROGRES në vitin 2012 është zgjedhur në mesin e katër projekteve fituese globalisht.

Themelimi i partneriteteve të forta me Ministrinë (MMJMPH, MEZHR, MBTPU) dhe institucionet (p.sh., Zyra për zhvillim të qëndrueshëm të zonave të pazhvilluara - ZZHQZP), kurse në anën tjetër me donatorët ndërkombëtar (si MISP, MSP IPA 2007, USAID apo SAFEGE) bëri që qeveritë lokale të marrin ndihmën e nevojshme dhe këshilla për të kryer projekte komplekse dhe që të mund në të ardhmen të kontribuojnë me ko-financimin e projekteve të gatshme.

Sidoqoftë, viti ishte i vështirë, me kushte të motit shumë të rënda të cilët pothuajse kanë ndërprerë të gjitha aktivitetet për disa muaj, ndërsa zgjedhjet lokale edhe më shumë kanë shkaktuar vonesë për shkak të fushatës intensive të politikanëve lokalë. Megjithatë, pavarësisht këtyre mungesave, trendi pozitiv i shpenzimeve është vazhduar dhe Programi prej majit të vitit 2011 deri në maj të vitit 2012 ka katërfishuar shumën e mjeteve të shpenzuara. Deri në momentin e përgatitjes së raportit, në qershor të vitit 2012, 30% të fondeve janë shpenzuar, 19% shtesë janë kontraktuar kurse 40% janë në përgatitje e sipër.

Ky raport është shkruar në shtatë kapituj dhe ankese përkatëse. Në kapitullin 1 është paraqitur Informatat kyçe mbi progresin drejt qëllimit, rezultatet edhe arsyeja janë



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

euprogres

Program evropskog partnerstva sa opštinama

paraqitur në Kapitullin 2. Pasqyra e azhuruar e rreziqeve dhe supozimeve gjendet në kapitullin 3. Të gjitha të dhënat në lidhje me implementimin gjenden në kapitullin 4. Përshkimi i punës në qëndrueshmërinë mund të gjendet në kapitullin 5, përderisa monitoringu (mbikëqyrja) dhe planet për vlerësimin e Programit janë sqaruar në kapitullin 6. Kapitulli 7 përshkruan leksionet e mësuara gjatë viti të dytë të implementimit të Programit.